



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.12.2013, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3292/13, për z. Sylë Hoxha - Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i rihapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Sylë Hoxha – Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në biznesin privat “Avokat Sylë Hoxha”, të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik

Rasti me numër protokolli AKK-03-4770/11, për zyrtarin e lartë z. Hoxha është trajtuar për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik, që lidhet me funksionin e tij si u.d i Kyeprokurorit të Prokurorisë së Qarkut në Prizren, dhe si person i autorizuar në biznesin privat “Avokat Sylë Hoxha”.

Zyrtari i lartë kishte bërë paraprakisht ç’regjistrimin në Oden e Avokatëve të Kosovës dhe e kishte sjellë në Agjenci, me ç’ka dhe rasti ishte mbyllur. Por rasti është rihapur konform nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, sepse zyrtari i lartë nuk i kishte bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve.

Zyrtari i lartë është informuar dhe është këshilluar, të bëjë ndryshimet e nevojshme në mënyrë që të shmanget situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë z. Hoxha ka deklaruar, si edhe më parë, se është i ç'regjistruar në Oden e Avokatëve të Kosovës, me ç'ka ka besuar se është shmang situata e mundshme e konfliktit të interesit, prandaj zyrtari i lartë z. Hoxha ka pranuar rekomandimin e Agjencisë që të bëjë ndryshimet edhe në Agjensinë për Regjistrimin e Bizneseve.

Zyrtari i lartë z. Hoxha ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03- 4075/13) në të cilën vërtetohet se është bërë asgjësimi, shuarja e biznesit privat "Avokat Sylë Hoxha", me çka ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

